



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:214862

Datë: 11.06.2024

Numri i dokumentit: 05808774

KPPP.nr. 1646/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Arbër Rexha, në çështjen përbarimore të kreditorit D.P.T “AgroFitimi”, me numër unik identifikues 810241745 dhe seli në Gjakovë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Ylli Bokshi, avokat nga Gjakova, kundër debitorit “Dinibat Material KS” Sh.P.K, me numër unik identifikues 811996985 dhe seli në Rahovec, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Bahrije Xhyliqi, avokate nga Malisheva, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përbarimor P.nr. 623/23, i lejuar me datë 18.09.2023, nga Përbaruesi Privat Gjokë Radi, me seli në Gjakovë, jashtë seancës, me datë 11.06.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit “Dinibat Material KS” Sh.P.K, me numër unik identifikues 811996985 dhe seli në Rahovec, ushtruar ndaj Urdhrit Përbarimor P.nr. 623/23, i lejuar me datë 18.09.2023, nga Përbaruesi Privat Gjokë Radi.
- II. Urdhri Përbarimor P.nr. 623/23, i lejuar me datë 18.09.2023, nga Përbaruesi Privat Gjokë Radi, MBETET NË FUQI.
- III. DETYROHET debitori që në emër të shpenzimeve për përpilimin e përgjigjes në prapësim, t’ia paguaj kreditorit shumë prej EUR 208.00 (dyqind e tetë Euro), në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi.

## A r s y e t i m

Përmbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit D.P.T “AgroFitimi”, mbi bazën e dokumenteve të besueshme – Faturës nr. 23-SHV05-003-1, e datës 27.06.2023 dhe Faturës nr. 23-SHV01-001-259, e datës 17.06.2023, ka lejuar Urdhrin Përmbarimor P.nr. 623/23, të datës 18.09.2023, me të cilin është urdhëruar debitori “Dinibat Material KS” Sh.P.K, që brenda afatit prej 7 ditësh nga dita e pranimit të urdhrin, kreditorit t’ia paguaj borxhin në shumë prej EUR 22,355.00, me kamatë ligjore nga dita e lëshimit të faturave, e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore.

Debitori, përmes përfaqësuesit të autorizuar brenda afatit ligjor ka ushtruar prapësim me të cilin e ka kundërshtuar urdhrin përmbarimor, me arsyetimin se dokumenti në bazë të së cilit është marr vendimi përmbarues nuk ka tipare të përmbarueshmërisë. Ka shtuar se me kreditorin kanë raporte kontraktuale dhe obligime të pa shlyera ndaj njëri tjetrit, mirëpo vlera e borxhit sipas urdhrin përmbarimor është e pa pranueshme dhe jo reale. Më tej, ka theksuar se borxhin sipas faturës së datës 17.06.2023 në vlerë prej EUR 1,529.50 nuk e konteston dhe ka premtuar se do ta përmbushë të njëjtin, ndërsa borxhin sipas faturës së datës 24.06.2023 e ka kontestuar dhe se e njëjta faturë nuk paraqet titull ekzekutiv dhe nuk ka tipare të përmbarueshmërisë. Në fund, ka theksuar se borxhi ka mbetur pa paguar nga shkak se këtu kreditori ka detyrime të pashlyera ndaj këtu debitorit. Për këto arsye, i ka propozuar gjykatës që të aprovojë prapësimin e debitorit, ndërsa urdhrin përmbarimor ta shfuqizojë.

Kreditori, përmes përfaqësuesit të autorizuar në përgjigje në prapësim e ka kundërshtuar prapësimin e debitorit me arsyetimin se urdhri përmbarimor është lejuar në bazë të dokumentit të besueshëm – faturave të cilat janë të nënshkruara nga debitori, si dhe i njëjti nuk ka paraqitur asnjë dëshmi për pagesën e tyre. Ka shtuar se debitori ka parashtruar fakte dhe rrethana të cilat janë deklarative e që nuk janë në përputhje me shkaqet e parapara sipas nenit 71 të LPP-së. I ka propozuar gjykatës që të refuzojë prapësimin e debitorit si të pa bazuar, si dhe kreditorit t’ia kompensojë shpenzimet për përpilimin e përgjigjes në prapësim në vlerë prej 312.00 €, sipas tarifës së OAK-së.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, pretendimeve të kreditorit të paraqitura në përgjigjen në prapësim, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-

139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje: “LPP”) gjeti se prapësimi i debitorit është i pabazuar dhe vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi, për këto arsye:

Sipas nenit 29, paragrafi 1 i LPP-së, “*Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm*”, ndërsa pika 1.3 e të njëjtit nen përcakton faturën si dokument i besueshëm sipas të cilës mund të caktohet përmbartimi për realizimin e kërkesës në të holla. Tutje, me paragrafin 3 të të njëjtit nen parashihet se: “*Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar*”. Në anë tjetër, sipas nenit 37 të LPP-së: “*Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit*”.

Gjykata vlerëson se përmbartuesi privat ka lejuar urdhrin përmbartimor mbi bazën e dokumentit të besueshëm, përkatësisht Faturës nr. 23-SHV05-003-1, e datës 24.06.2023 dhe Faturës nr. 23-SHV01-001-259, e datës 17.06.2023, fatura këto të cilat i përmbajnë të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm siç kërkohet me nenin 29, paragrafi 3 të LPP-së, për arsye se në secilën prej tyre janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë emërtuar mallrat me të cilat është shërbyer debitori, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi. Poashtu, gjykata gjen se e njëjta faturë është lëshuar me rregull nga ana e kreditorit, ndërsa është pranuar dhe nënshkruar nga debitori dhe nuk është kundërshtuar më parë.

Rrjedhimisht, gjykata vlerëson se në rastin konkret faturat mbi bazën e së cilave është lejuar urdhri përmbartimor, i plotësojnë kushtet në kuptim të nenit 37 të LPP-së, për zbatimin e përmbartimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që të njëjtat i janë bashkëngjitur propozimit për përmbartim në origjinal.

Gjykata ka vlerësuar pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim se këtu kreditori ka obligime ndaj debitorit të përmbartimit dhe për këtë arsye nuk është bërë pagesa sipas faturës së datës 24.06.2023, mirëpo gjeti se të njëjtat pretendime nuk mund të jenë objekt trajtimi në këtë procedurë për arsye se procedura përmbartimore i nënshtrohet parimit të rigorozitetit formal, në bazë të cilit nuk lejohet vlerësimi i rrethanave tjera, përjashtimisht vlerësimi të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbartimi, si dhe përshtatshmërisë së dokumentit objekt përmbartimi, ashtu siç kërkohet me dispozitat të LPP-së.

Megjithatë, gjykata sqaron se vendosja në këtë çështje përmbartimore nuk paraqet pengesë për debitorit që pretendimet e tij lidhur me kërkesat e pa përmbushura të kreditorit të inicioj procedurë ligjore pranë gjykatës kompetente.

Përfundimisht, gjykata vlerëson se pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim nuk paraqesin bazë në kuptim të nenit 71 të LPP-së për anulimin e urdhrit përmbartimor, ndërsa në mbështetje të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit u vendos jashtë seancës.

Për shpenzimet e procedurës përmbartimore gjykata vendosi në kuptim të dispozitave të nenit 463 të LPK-së, lidhur me nenin 13 dhe 17 të LPP-së, duke ia njohur shpenzimet kreditorit në emër të paraqitjes së përgjigjes në prapësim përmes përfaqësuesit të autorizuar, në vlerë prej EUR 208.00, konform rregullores mbi tarifat e avokatëve.

Nga sa më sipër, bazuar në nenin 73, paragrafi 3 të LPP-së, nenin 13, paragrafi 1, pika 1.2, dhe Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

#### GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 1646/23, datë 11.06.2024

Gjyqtari  
Arbër Rexha

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.